



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3090 Prot.

Vlorë, më 17/10/2024

**Lënda :** *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Kontabilizimit)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse



Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të një akti administrativ – Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore” si vijon :

• Nr.124, me Nr.2470/2 Prot., datë 09/09/2024, i materializuar për subjektin “MAGS SHOES” sh.p.k, me NUIS L66412202O, me seli në Vorë (Lagjia “Rilindja”, Rruga “Riza Salati”, godinë 4 katëshe), me administrator z.Antonio Specchio.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 1 (një) fletë.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.2470/2 Prot.

Vlorë, më 09/09/2024

**VENDIM Nr. 124**

Sot, më datë 09/09/2024, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore Nr.serial 0025215, nr.2470 Prot., datë 20.08.2024, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L66412202O, me seli në Vlorë, si dhe praktikën doganore,

**KONSTATOVA SE:**

Rezulton se subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L66412202O ka përfituar nga D.P.D autorizimin për përdorimin e R.P.A Nr.AL 30663/1, datë 09.04.2022, me vlefshmëri kohore 4 muaj. Rezulton se nga ana e subjektit është administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë shkresa me nr.2139 Prot., datë 19/07/2024, me lëndë "Dorëzim mbyllje autorizimi Nr.30663/1 datë 09.04.2024". Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit, autorizimi i lartcituar nuk është mbyllur në mënyrë të saktë, pasi ka diferencë vlere të parieksportuar. Në përfundim, rezulton nga ana e subjektit është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative dhe për këtë fakt, është mbajtur Proces - Verbali i shkeljes doganore nr.2470 Prot., datë 20.08.2024, i cili i është njoftuar subjektit. Për sa më lart, mbështetur në nenet 250/1/a, 259/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor",

**VENDOSA:**

- Subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L66412202O, të penalizohet në shumën **20,000** (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 259/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NUIS L66412202O, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**

